

D.298.33.2, FDH-30884; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), D.298.33.3, FDH-30888; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; SHFĐUÇK, *Feniksët...* 2, 21, 22.

## Myrtë (Rexhë) Zeneli

(11.10.1962, shqiptar nga Jablanica/Jablanica, komuna e Pejës/Peç, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Myrtë Zeneli ka marr pjesë në demonstratat e viteve 1989 dhe 1990 kundër regjimit serb. Në muajin prill të vitit 1998, u emërua komandant lokal i UÇK-së. Ka rënë në përlëshjet e armatosura me forcat serbe që u zhvilluan në **Dollovë/Dolovo** më **21.05.1998**. Përpos nofullës së tij, e cila ishte gjetur në pyll në vendin ku ka rënë në betejë, mbetjet e tij të tjera mortore nuk janë gjetur kurrë. Familjarët e kanë varrosur nofullën pranë xhamisë në Jablanicë/Jablanica, ndërkaq në vitin 2005 e kanë riarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Jablanicë/Jablanica. Në listën e të zhdukurve të KNKK-së, lënda e tij është evidentuar me numër BLG-804384-01.

**Burimet:** deklarata A.Z, FDH-6699; deklarata B.Z, FDH-33451; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; SHFĐUÇK, *Feniksët...* 6, 217-219.

## Xhezair (Xhafer) Syla

(10.04.1975, shqiptar nga Grabanica/Grabanica, komuna e Klinës/Klina, pjesëtar i UÇK-së)

## Arben (Istref) Krasniqi

(2.11.1978, shqiptar nga Grabanica/Grabanica, komuna e Klinës/Klina, student, pjesëtar i UÇK-së)

Arbeni dhe Xhezairi kanë qenë pjesëtarë të UÇK-së. Përpara se të inkuadrohej në UÇK më 15.03.1998, Arbeni ka qenë student i Fakultetit Juridik në Prishtinë/Priştina. Xhezairi dhe Arbeni kanë marrë pjesë në luftimet treditëshe të forcave të UÇK-së me ato serbe [19 -21.05.1998] në **Grabanicë/Grabanica**. Kanë rënë më **21.05.1998**. Forcat serbe i kanë varrosur trupat e tyre buzë lumit. Familjarët kanë mësuar për këtë vetëm pas përfundimit të luftës, në muajin dhjetor të vitit 1999, nga një djalë i cili ishte dëshmitar i kësaj ng-

jarjeje. Në datën 22.12.1999, familjarët i kanë riarrosur mbetjet mortore të Xhezairit dhe Arbenit në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Grabanicë/Grabanica.

**Burimet:** deklarata U.S, FDH-30715; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; *Remains in Volljake May Well Belong to Albanian Victims*, *Lokal Sources Say*, pasqyra e lajmeve, KIC, 4.10.1998, FDH-29723.

## Faruk (Kamber) Elezi

(1.06.1977, shqiptar nga Gjurgjeviku i Vogel/Mali Đurdevik, komuna e Klinës/Klina, student, pjesëtar i UÇK-së)

Faruku ka qenë student i Fakultetit Ekonomik në Prishtinë/Priştina. Ka aderuar në radhët e UÇK-së në muajin dhjetor të vitit 1997. Ka rënë gjatë betejës me forcat serbe që u zhvillua më **21.05.1998** në **Grabanicë/Grabanica**. E kanë varrosur në Jablanicë/Jablanica [Gjakovë/Đakovica]. Pas përfundimit të luftës, më 24.08.1999, familjarët i kanë riarrosur mbetjet e tij mortore në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Glligjan/Glodane [Deçan/Deçani].

**Burimet:** deklarata K.E, FDH-33520; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; SHFĐUÇK, *Feniksët...* 6, 61-64.

## Zekë (Azem) Brahimi

(1931, shqiptar nga Bokshiqi/Bokšić, komuna e Klinës/Klina, pensionist, tre fëmijë)

Zeka e kishte fituar pensionin në Gjermani. Pas pensionimit, ai u kthye në **Bokshiq/Bokšić**. Jetonte në bashkësi familjare me djemtë e vëllait, i cili punonte në Gjermani, dhe bashkëshorten e vëllait të tretë, i cili kishte ndërruar jetë. Në mbrëmjen e datës 21.05.1998, forcat serbe i kanë sulmuar pozicionet e UÇK-së në fshat. Familjarët e Zekës, sikurse edhe të gjithë bashkëfshatarë të tjerë, e braktisën fshatin dhe u strehuan në bjeshkën përmbi fshatin e Bokshiqit/Bokšić. Zeka ndenji në fshat me burra të tjerë. Ditën e nesërme, më **22.05.1998**, forcat serbe e përsëritën sulmin mbi Bokshiqin/Bokšić. Pas depërtimit në fshat, nisën tu vënin zjarrin shtëpive. Ia